



LAJME nga FONDACIONI
ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË
Tiranë

N.14
Shkurt
2025

Redaksia "ZKM ALBANIA"
Kompleksi Spitalor Universitar
"Zoja e Këshillit të Mirë"
Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë

unikzkm
unikzkm
www.unizkm.al
pr@fzkm.org

01

"I DREJTI" I VITIT 2025

■ Një proces transparent,
qytetar dhe demokratik

Në datën **16 janar 2025** në Kampusin Universitar dhe Spitalor "Zoja e Këshillit të Mirë" dhe në Poliambulancën "At Luigji Monti" në Rrugën e Kavajës në Tiranë u zhvillua për herë të parë votim i fshehtë dhe gjithëpërfshirës për të zgjedhur "Të Drejtin e viti 2025".

Kjo ishte një ngjarje që do të mbetet gjatë në historinë e Kampusit tonë Spitalor dhe Universitar sepse për herë të parë studentë, profesorë, të ftuar, miq, pacientë dhe vizitorë u bashkuan rreth një procesi transparent, qytetar dhe demokratik për përzgjedhjen e "Të Drejtin" të vitit 2025.

Garën e fitoi Ish-Presidenti i Republikës së Kosovës Ibrahim Rugova, i cili fitoi mes kandidatëve që ishin gjithashtu profile të jashtëzakonshme modelesh qytetarie, humanizmi dhe lirie. Ibrahim Rugova lindi në vitin 1944. Ai u zgjodh kryetar i Partisë "Lidhja Demokratike e Kosovës" (LDK) në vitin 1989. Me përpjekjet e tij u kushtua arritjes së pavarësisë së Kosovës në mënyrë paqësore, duke krijuar një lloj

Një ngjarje që do të mbetet gjatë në historinë e Kampusit tonë Spitalor dhe Universitar

"qeverie në hije" të krahinës që para viteve '90 ishte pjesë e Federatës Jugosllave. Administrimi i Kosovës në këtë periudhë siguroi ngritjen e shkollave dhe spitaleve, të cilat u mbështetën tek kontributi i shqiptarëve që jetonin jashtë territorit. Rugova mbështeti rrugën paqësore edhe për të ndalur gjakmarrjen, një zakon shoqëror të rrënjosur thellë në këtë shoqëri. Pas vetëshpalljes së Kosovës Republikë në vitin 1992 nëpërmjet referendumit, Rugova u bë president i saj i parë. **Gjatë luftës së viteve 1998-1999 për çlirimin e Kosovës ai ishte një pikë e rëndësishme referimi politik dhe ndërkombëtar edhe për qeveritë perëndimore.**

Rezistenca me durim dhe përkushtim paqësor ndaj regjimit serb të Slobodan Millosheviçit e frymëzoi veprimtarinë e tij politike gjatë gjithë krizës së vështirë kosovare, të fundviteve '90 dhe mesit të viteve 2000. Për këto arsye ai u quajt si "Gandi kosovar". Ai ndërroi jetë në janar të vitit 2006.



IBRAHIM RUGOVA

■ 16 janar 2025, angazhim qytetar për jetën

Emri i personit më të votuar që fitoi në zgjedhjet e 16 Janarit do të gdhendet gjatë muajit Mars 2025 në një nga gurët e "Kopshtit të të Drejtëve" që ndodhet në Kampusin tonë multikulturor dhe ndërkombëtar. Ceremonia e inaugurimit të "Të Drejtës" të vitit do të kryhet sikur një vit më parë në prani të profesorëve, studentëve, punonjësve dhe ekipit mbështetës të trupës akademike e spitalore të UKZKM. Në garën e këtij viti për të zgjedhur një fitues ishin **Anëtarët e "Trëndafil të Bardhë", Adriano Olivetti, Cicely Saunders, Ibrahim Rugova dhe Antonio Megalizzi.** Kandidaturat morën vlerësime të ndryshme gjatë votimit të fshehtë dhe u pëlqyen nga qindra pjesëmarrës që morën pjesë në



procesin e votimit të fshehtë. "Kopshti i të Drejtëve" u çel për herë të parë në Shqipëri në 6 Mars të vitit 2024 si inisiativë e Fondacionit Zoja e Këshillit të Mirë. Në hapësirën e tij janë vendosur gurë dekorativë tek të cilët gdhendet emri i "Të Drejtës", duke treguar kështu bukurinë e përhershme të shembullit të këtyre njerëzve.

Përmes kësaj iniciative Fondacioni Zoja e Këshillit të Mirë synon të promovojë mes studentëve, punonjësve dhe të ftuarve dimensionin shpirtëror të jetës, qytetarinë aktive dhe ndjeshmërinë ndaj të mirës së përbashkët.



Kopshtet e të Drejtëve u krijuan për të nderuar gratë dhe burrat që përballë ngjarjeve të mëdha morën përgjegjësinë personale për të mbrojtur dinjitetin njerëzor dhe për t'u ardhur në ndihmë viktimave apo të pambrojturve. Kopshtet kanë detyrën t'i paraqesin si shembull opinionit publik ata persona që edhe duke rrezikuar jetën e vet kanë dalë kundër vështirësive dhe kanë ruajtur vlerat njerëzore përballë ligjeve të padrejta apo indiferencës së shoqërisë. "I drejti" i parë, emri i të cilit u gdhend në një nga gurët e Kopshtit ishte Carlo Urbani me motivacionin si "Mjek i sëmundjeve infektive, i cili lajmëroi i pari në botë epideminë SARS-CoV-1 (2002-03)". Ai u prek vetë nga ky virus dhe vdiq në Bangkok më 29 mars 2003 në moshën 47 vjeçare. Ai tregoi kompetencë dhe përgjegjësi në misionet e tij humanitare pa kufij dhe duke u dedikuar tërësisht.



■ Znj. Simona Cruciani viziton Kampusin, voton edhe për "Të Drejtin"

Kampusi Qëndror i Universitetit dhe Spitalit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" pati nderin të mikpriste një vizitore të veçantë, Znj. Simona Cruciani, Zyrtare e Çështjeve Politike nga Zyra e Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Gjenocidit dhe Përgjegjësinë për Mbrojtjen.

Znj. Cruciani u prit nga Presidenti i Fondacionit Zoja e Këshillit të Mirë fr. Ruggero Valentini dhe u takua me drejtues e profesorë të stafit akademik të UKZKM. Në një nga sallat e universitetit u zhvillua një bashkëbisedim dinamik, i cili shërbeu për të dëgjuar mbi rolin e Zyrës së Kombeve të Bashkuara në luftën kundër dhunës, urrejtjes dhe gjenocidit dhe për të shkëmbyer pikëpamje mbi sfidat me të cilat përballen sot Kombet e Bashkuara dhe rajone të ndryshme në botë.

Zonja Cruciani tregoi për eksperiencën e saj dhe iu pergjigj pyetjeve të audiencës së nderuar gjatë takimit,



duke shtuar se zyra të cilën ajo përfaqëson monitoron dhe raporton për rastet e evidentuara të gjenocidit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara. Përfaqësuesja ndërkombëtare pas takimit u nderua nga Presidenti i Fondacionit fr. Ruggero Valentini me medalionin ku janë shënuar fjalët e Shenjtes shqiptare Nënë Tereza, e cila ka bekuar të gjithë ata që do të angazhohen në mbarëvajtjen e kompleksit të madh universitar dhe shëndetësor të "Zojës së Këshillit të Mirë" në Shqipëri.

Pas marrjes së medalionit ajo falenderoi drejtuesit e Fondacionit dhe UKZKM për mikpritjen dhe tha se fjalët e Nënë Terezës do t'i mbante gjithmonë mbi tryezën e saj të punës, si shenjë e një vizite të bukur në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë".

Zonja Cruciani shënoi përshtypjet e kësaj vizite në librin e miqve dhe më pas ndoqi disa momente nga procesi i votimit që u krye për të zgjedhur "Të Drejtin" e vitit 2025. E ftuara u njoh me kandidaturat dhe pranoi të hidhte votën e saj për një prej tyre.



Zyrtarja e Çështjeve Politike nga Zyra e Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Gjenocidit dhe Përgjegjësinë për Mbrojtjen vizitoi Kopshtin e "Të Drejtëve" në Kampusin tonë dhe tha gjatë kësaj vizite se kishte vizituar disa kopshte të "Të Drejtëve" në disa vende të botës.

Ajo përgëzoi Fondacionin Zoja e Këshillit të Mirë për ndërtimin e Kopshtit të parë në Shqipëri brenda Kampusit të UKZKM, duke mbështetur mesazhin që japin "Të Drejtët" në botë, si kampionë të mbrojtjes së të drejtave të njeriut.



04


EMANUELE STABLUM

■ Një mjek “i drejtë”

Në muajin që përkujton të “Drejtët” e njerëzimit kujtojmë dëshminë e një besimtari anëtar të Komunitetit Montian, i cili e ushtroi profesionin e tij si mjek me përkushtim dhe kompetencë të veçantë.

Bëhet fjalë për vëlla Emanuele Stablum, i cili vdiq më 16 mars 1950 dhe që shteti i Izraelit e shpalli të “Drejtë midis Kombeve” pasi kishte shpëtuar pesëdhjetë hebrenj gjatë Luftës së Dytë Botërore (dhe po aq të përndjekur politikë nga fraksionet kundërshtarë). Sot doktor Stablum është shpallur gjithashtu “I nderuar” nga Kisha Katolike për faktin se ka treguar një besim bujar dhe të guximshëm. Për të u shkrua libri “Le alte vie di Emanuele Stablum – Medico dell’anima, sacerdote del corpo”, nga presidenti jonë, fr. Ruggero Valentini.

Ky libër është i disponueshëm për lexuesit në bibliotekën e universitetit.



05

VULLNETARËT E VOTIMIT

■ Mesazh falenderimi për djemtë dhe vajzat e procesit

Gjatë ditës së votimit në 16 janar 2025 për të zgjedhur “Të Drejtin” e vitit u angazhuan të rinj e të reja si vullnetarë, të cilët ndihmuan për të mbikëqyrur procesin e mirëorganizuar të votimit të fshehtë.

Në katër qendra votimi të vendosura në Kampusin Spitalor dhe Universitar dhe në Poliambulancën At’ Luigji Monti në “Rrugën e Kavajës” qëndruan gjatë gjithë ditës studentë dhe të rinj të Baritores së Universitetit

bashkë me At Pascalin. Ata të gjithë i dhanë mbështetje procesit të mbarëvajtjes së votimit duke mbajtur me saktësi të dhënat dhe materialet zgjedhore.

Fondacioni Zoja e Këshillit të Mirë i falenderon të gjithë të rinjtë që u angazhuan vullnetarisht në datën 16 Janar, duke treguar se mbështesin vlerat qytetare në jetën e tyre të përditshme.



Faleminderit për At Paskal, për të rinjtë Francy, Rafaele, Mirko, Sonja Ndokaj, Klea, Alessia, Bernarda, Francesco, Vivian, Elma, Francesca, Marinella, Maria Cristina, Bora, dhe Kevin.

16 Janari do të mbetet në historinë e Kampusit si një ditë e bukur qytetarie.

06

FRANÇESKO NUK DO RËZOHET

■ Messaggio di pace

Lidhur me temën e paqes duhet t'i mbajmë sytë hapur dhe veshët e vëmendshëm, në mënyrë që të mos na pushtojë indiferenca. Në këtë vit të Jubileut 2025, (shih artikullin më vete) Papa Françesku ndërhyri me një Mesazh stimulues dhe konkret. Teksti në shqip është i disponueshëm pa pagesë në disa pika të Fondacionit tonë (Casa Rossa, Biblioteka, Poliambulanca, Spitali).



Ju ftojmë ta lexoni, duke ofruar këtu vetëm dy fragmente shumë domethënëse:



Ju ftojmë ta lexoni, duke ofruar këtu vetëm dy fragmente shumë domethënëse:

“Edhe sot, Jubileu është një ngjarje që na shtyn për ta kërkuar drejtësinë çliruese të Hyjit në mbarë atdheun. Në vend të bririt, në fillim të këtij Viti të Hirit, dëshirojmë të vihemi në dëgjim të “britmës së dëshpëruar për ndihmë” që, ashtu si zëri i gjakut të Abelit, të drejtit, ngrihet nga shumë anë të botës (krh. Zan 4,10) e që Hyji s’pushon kurrë së dëgjuari. Edhe ne ndihemi të thirrur që t’u japim zë shumë situatave të shfrytëzimit të tokës e të shtypjes së të afërmit. Këto padrejtësi ndonjëherë marrin pamjen e asaj që Shën Gjon Pali II i përcaktoi si “struktura të mëkatit”, pasi ato nuk janë vetëm shkak të paudhësisë së disave, por, si të thuash, janë konsoliduar dhe mbështeten mbi një bashkëfajësi të zgjeruar (...)

Secili prej nesh duhet të ndihet në një farë mënyre përgjegjës për rrënimin të cilit i është nënshtruar shtëpia jonë e përbashkët, duke u nisur nga ato veprime që, qoftë edhe vetëm në mënyrë indirekte, ushqejnë konfliktet që po e frushkullojnë njerëzimin. Kështu, sfidat sistemore, të dallueshme, por të ndërlydhura, që e prekin planetin tonë, nxiten dhe ndërthuren. I referohem, në veçanti, pabarazive të çdo lloji, trajtimit çnjerëzor ndaj emigrantëve, degradimit të mjedisit, konfuzionit të shkaktuar fajësisht nga keqinformimi, refuzimit të çdo lloj dialogu, financimit të madh në industrinë ushtarake. Të gjitha këto janë faktorë të një kërcënimi konkret ndaj ekzistencës së mbarë njerëzimit.



Në italisht ose gjuhë të tjera mund ta gjeni në faqen

<https://www.vatican.va/content/francesco/it/messages/peace/documents/20241208-messaggio-58giornatamondiale-pace2025.html>

07

NJË UDHËTIM SHPRESE

■ Pelegrinazhi Ynë për Jubileun 2025



Çdo 25 vjet, Kisha na fton të kremtojmë një kohë kujtese dhe pelegrinazhi. Në vitin 2025, kremtojmë Jubileun e Shpresës (Rom 5:5), një mundësi e jashtëzakonshme për të rizbuluar vlerën e fesë, edukimit dhe komunitetit. Ne do ta përjetojmë këtë ngjarje me një pelegrinazh të veçantë, duke bashkuar përshpirtërinë, kulturën dhe bashkëndarjen. **Nga 23 korriku deri më 6 gusht 2025, do të fillojmë udhëtimin tonë në Saronno, duke festuar 200-vjetorin e At Montit, për të vazhduar më pas drejt Romës më 28 korrik.** Atje do të zhytemi në një përvojë rritjeje dhe vëllazërie, duke takuar të rinj nga e gjithë bota dhe duke forcuar angazhimin tonë për një të ardhme të ndriçuar nga shpresa. Do të jetë një udhëtim i thellë, i mbushur me lutje, dialog dhe momente reflektimi, por edhe një mundësi për të krijuar lidhje dhe për t’u ndjerë pjesë e një familjeje të vetme. Bashkohu me ne në këtë pelegrinazh shprese, për të ecur së bashku drejt së ardhmes me besim dhe gëzim!

08

ANASTASI, LUIGJI, GJONI, ENJGJËLLI

■ Lajmet e kishës: njerëzit dhe rolet

Gjatë muajit janar jeta e kishave në Shqipëri u karakterizua nga disa ngjarje të rëndësishme. Lajmi për ndarjen nga jeta të Primatit të Kishës Ortodokse në Shqipëri, Anastasit, në moshën 95-vjeçare, i cili udhëhoqi këtë komunitet të krishterë që në momentin e parë të lirisë së vendit, pati një impakt të madh ndërkombëtar. Për 33 vjet ai ofroi një shërbim baritor të ndritur dhe të ndjeshëm, të rrënjësuar fort në Ungjill.

Luigi Bonazzi, në fund të mandatit të tij si Nunc Apostolik u kthye në Itali dhe Kisha Katolike është në pritje për emërimin e një përfaqësuesi të ri nga Papa. Kalimi i stafetës edhe në Shkodër, ku Arqipeshkvi Angelo Massafra, italian me origjinë arbëreshe, dha dorëheqjen për arsye moshe pas njëzet vitesh shërbim (më parë kishte qenë ipeshkëv për dy vjet në Rrëshen). Në vend të tij ka ardhur Giovanni Peragine, një fetar barnabit, misionar prej vitesh dhe më pas Administrator Apostolik i Shqipërisë së Jugut që nga viti 2017.



09

DIPLOMATËT, ENDËSIT E PAQES

■ Ambasadorë në lëvizje



MARCO ALBERTI
Ambassador of Italy to Tirana

Në një moment kaq kompleks si ky aktual, mes luftërave dhe fërkimeve Ndërkombëtare, figura e ambasadorëve shfaqet në rolin e ndërmjetësit, të paqe bërësit. Fondacioni ynë gëzon miqësinë e disa prej tyre, veçanërisht të Italisë, Brazilit dhe Spanjës.

Ambasadori italian Fabrizio Bucci përfundoi mandatin e tij në janar dhe më pas u transferua në një mision shumë të rëndësishëm në zemër të Evropës, në Berlin.

Ndërkohë, një përfaqësues i ri i Italisë, Marco Alberti ka mbërritur në cilësinë e diplomatit, i ardhur nga ambasada në Kazakistan.

10

ARTERIOGRAFIA

■ Një investim i standarteve të larta

Në Spitalin Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” vazhdon të investohet për të rritur kapacitetet teknologjike në shërbim të pacientëve dhe mbrojtjes së shëndetit të njerëzve. Një nga investimet e fundit është ndërtimi i sallës së re ku do të kryhen teknikat mjekësore për qëllime diagnostikuese nëpërmjet arteriografisë. Salla që po ndërtohet nga projektues italianë në bashkëpunim me arkitektë shqiptarë siguron kushtet optimale për monitorimin e pacientëve, duke siguruar imazhe mjekësore të një cilësie shumë të lartë pamore.



Në numrin pasardhës të ZKMALBANIA do të japim më shumë detaje rreth këtij investimi.

■ Studentët e Mjekësisë studiojnë me teknologjinë e fundit

Inovacioni dhe mbështetja teknologjike në programet tona të studimit është një nga tiparet dalluese të UKZKM si lider i edukimit profesional të studentëve në Shqipëri. Së fundmi në Universitetin Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” u shtua “Anatomage” një aset teknologjik i rëndësishëm në fushën e Mjekësisë, veçanërisht i dobishëm në lëndën e Anatomisë. “Anatomage” është një aparat digjital që ndihmon në paraqitjen e strukturave makro dhe mikroanatomike në projektionin tredimensional.



Gjatë muajit Janar u zhvillua trajnimi i parë në lidhje me mënyrën e përdorimit të kësaj paisjeje. “Anatomage” hyn si mbështetje e programeve të studimit në UKZKM në versionin më të përparuar teknologjik të kohës dhe është plotësisht funksional dhe i gjithi në dispozicion të studentëve. Sipas Dekanit të Fakultetit të Mjekësisë në UKZKM Prof. Guido Macchiarelli është programuar

një tjetër trajnim online, gjatë të cilit mund të marrin pjesë të gjithë të interesuarit, duke përdorur mundësitë e komunikimit në streaming. Gjatë fundit të muajit Shkurt specialistë të kualifikuar në përdorimin e këtij aparati, do të vizitojnë kampusin e UKZKM, për të bërë edhe vlerësimet përkatëse të autorizuar nga kompania prodhuese e kësaj paisjeje.



Pjesë e vizitës së specialistëve është edhe bashkëbisedimi me studentët e mjekësisë, si përfitues të mësimit me këtë paisje digjitale, duke rritur aftësitë e tyre didaktike në programet e studimit.



■ Un'occasione unica

Në kuadër të programit të shkëmbimit ndërkombëtar të stafit, në Erasmus+, **Prof. Antonella Biscione** e Departamentit për Strategjitë në Bashkimin Evropian dhe Ballkan, realizoi një mobilitet didaktik në Fakultetin e Menaxhimit, Ekonomisë dhe Shkencave të Universitetit Katolik të Lille nga data 13 deri më 17 janar 2025. Gjatë qëndrimit të saj, ajo mbajti leksione për ekonominë e inovacionit, drejtuar studentëve të Masterit në Administrim Biznesi dhe Menaxhim.



Ndërkombëtar. Një mundësi unike për të nxitur debatin mbi një temë strategjike dhe për të pasuruar vizionin e tyre për botën bashkëkohore ekonomike, si dhe për të nxitur ndërvëprimin midis perspektivave të ndryshme akademike dhe profesionale. Gjithashtu, këto aktivitete forcojnë prestigjin dhe rrjetin e bashkëpunimit të universitetit tonë, duke nxitur ndërkombëtarizimin e mësimdhënies dhe shkëmbimin e praktikave më të mira.

Në fund të muajit Janar në Universitetin Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” u shfaq dokumentari kushtuar dy magjistratëve italianë, Giovanni Falcone dhe Paolo Borsellino, një prodhim filmik që sjell për publikun profilet e dy njerëzve emblematicë të historisë së Italisë në fund të shekullit të 20-të.


Presidenti i Fondacionit Zoja e Këshillit të Mirë fr. Ruggero Valentini tha në nisje të organizimit se detyra jonë në universitet është të rrisim ndërgjegjen e të rinjve për të drejtat civile, për drejtësinë dhe ky dokumentar është një mundësi për studentët që të reflektojnë për shoqërinë dhe sakrificat që janë bërë për të mbrojtur shtetin ligjor dhe të mirën publike.



Dokumentari tregon momente dramatike të

çasteve të para pas atentateve mafioze që u morën jetën dy gjyqtarëve që luftonin kundër mafias dhe sjell dëshmi frymëzuese për triumfin e betejës për drejtësi. Dëshmitarë të mesit të viteve '90, bashkëpunëtorë dhe të afërm të magjistratëve të vrarë, përcjellin me vërtetësi dhe emocion kohët e trazuara të Italisë që

luftonte me organizatat kriminale. Mesazhi i dokumentarit është aktual në çdo kohë, për çdo vend që synon të ndërtojë një shtet ligjor. Falcone e Borsellino besonin tek triumfi i ligjit kundër mafies, ndaj nderimi e kujtimi për ta është detyrë e qytetarëve të angazhuar, e brezave të rinj që të çojnë para betejën për një të ardhme të sigurtë për të gjithë. Lufta pa kompromis e dy magjistratëve deri në përballjen me mafian duke sakrifikuar edhe jetën, padyshim që ka shënuar ndërgjegjen e dëshmitarëve që flasin në dokumentar, tw njerëzve që e jetuan atë periudhë sfiduese për Italinë, duke sjellë për të rinjtë dhe ata që do të vijnë jehonën e Falcone dhe Borsellino si heronj heronj të drejtësisë.



Ferdinant Banda është **përgjegjësi logjistik** i “Shtëpisë së Mikpritjes” në Kampusin Universitar “Zoja e Këshillit të Mirë”. Ai është bashkëpunëtor i Fondacionit ZKM që prej dhjetorit të vitit 1999 dhe është kujdesur për të gjitha detyrat administrative të Fondacionit dhe Universitetit në aspektin logjistik.

Detyra ime, thotë Ferdinant, më jep kënaqësi dhe ka qenë një rrugëtim i gjatë profesional dhe njerëzor që më ka mësuar shumë në çdo aspekt.

Ferdinanti prej vitesh punon në një mjedis ku komunikimi njerëzor dhe nevoja për efikasitet ka qenë sfidë që ai është përpjekur ta zgjidhë me sukses.

Shpesh puna ime lidhet me profesorët e huaj që zhvillojnë leksionet në UKZKM, tregon ai, dhe kjo marrëdhënie me ta më ka ndihmuar të përmirësoj më shumë veten dhe të jem i dobishëm për kampusin e bashkëpunëtorët tanë.

Ferdinanti punon prej gati tre dekadash në UKZKM dhe është i gëzuar për lidhjen e veçantë njerëzore që ka ushqyer me stafin dhe mundësitë që profili i punës i jep për të mësuar më shumë. Kur e pyet për të ardhmen dhe si e sheh punën e tij në vijimësi, Ferdinanti tregon me modesti se është i hapur ndaj sfidave që e rrisin atë profesionalisht, duke u ndjerë krenar për kontributin që ka dhënë në Fondacionin Zoja e Këshillit të Mirë.

■ Kultura e ushqyerjes si pjesë e mirëqenies së njeriut

Ushqyerja luan një rol themelor në parandalimin e sëmundjeve dhe është procesi jetik për mirëqenien e shëndetit të individit dhe popullatës në tërësi. Në një nga sallat e UKZKM prej 21-23 janar 2025 u zhvillua një kurs trajnues për studentë dhe profesionistë të rinj të mjekësisë nën udhëheqjen e Prof. Angela Andreoli dhe Prof. Ersilia Buonomo.

Kursi treditur kishte si qëllim që në përputhje me objektivat e mijëvjeçarit, të jepte informacion të gjerë



dhe praktik për problemet e epidemiologjisë dhe të ushqyerit njerëzor në kuadër të shëndetit global. Studentët dhe specialistët e rinj u njohën me bazat e epidemiologjisë, mbikëqyrjen dhe vlerësimin e gjendjes ushqimore të popullatës. Po kështu fituan përvojë të vyer në rëndësinë e vlerësimit të zakoneve të të ngrënit dhe respektimit të dietës mesdhetare në moshë të hershme, gjatë rritjes dhe moshës së tretë. **Prof. Angela Andreoli**



dhe Prof. Ersilia Buonomo ndanë me pjesëmarrësit njohuri rreth përdorimit të rezistencës bioelektrike për të vlerësuar përbërjen e trupit të njeriut, duke i mbështetur të dhënat e tyre mbi përvojën e vyer profesionale dhe akademike, standardet ndërkombëtare të vlerësimit dhe studime bashkëkohore që përfshijnë edhe kontributin e dy lektoreve të nderuara në fushën e ushqyerjes.



Më 11 shkurt 2025, në Ditën Botërore e të Sëmurëve, në sallën B105, në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", do të reflektojmë së bashku mbi dhimbjen dhe dhembshurinë që shoqërojnë vuajtjen. Një temë që prek thellësisht çdo zemër, sidomos në kulturën shqiptare, ku familja dhe komuniteti luajnë një rol të rëndësishëm në mbështetjen e atyre që vuajnë.

Dhimbja, ndonëse përjetohet si një vështirësi, bëhet një urë lidhëse dhe kuptimi. Mençuria popullore shqiptare na mëson se çdo vuajtje mund të kthehet në forcë dhe bukuri.

Për këtë temë do të diskutojnë **PhD Enkeleda Gjini**, koordinatore e Programit të Studimit në Infermieri dhe **PhD Emanuela Prendi**, koordinatore e Programit të Studimit në Fizioterapi në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë".

Në orën 8.30 në kapelën e spitalit do të kremtohet mesha e shenjtë.



■ Mirëqenia fizike

Studentët e Programit të Studimit në Fizioterapi pranë UKZKM janë bërë pjesë e një praktike të re që rrit aftësitë e tyre profesionale. Grupi i të rinjve nën udhëheqjen e PhD. Florian Spada si Përgjegjës i Praktikave Klinike pranë Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" morën pjesë në aktivitetin e organizuar nga "Padel Group Albania".

Studentët patën mundësinë të aplikojnë dhe zhvillojnë aftësitë e tyre profesionale duke përdorur metoda të ndryshme bashkëkohore të fizioterapisë.



Ky ishte një hap i rëndësishëm për përgatitjen e tyre akademike si studentë të Fizioterapisë në UKZKM, pasi krijon kushtet më të mira për përfundimin e njohurive që marrin në universitetin tonë. Nuk është hera e parë që studentët e Programit të Studimit në Fizioterapi pranë UKZKM bëhen pjesë e aktiviteteve jashtë kampusit universitar, sic janë maratonat, garat e disiplinave të ndryshme lokale dhe kombëtare, duke u siguruar të rinjve që të zhvillojnë aftësitë e tyre në një ambient thellësisht profesional.

Studentët janë entuziastë për këto mundësi praktike dhe thonë se këto përvoja i ndihmojnë të kuptojnë më mirë rolin e Fizioterapisë në përmirësimin e mirëqenies fizike së pacientëve, duke rritur paralelisht përgatitjen e tyre për sfidat e së ardhmes në këtë fushë kaq të rëndësishme mjekësore.

Katërmbëdhjetë Vëllezër të rinj të Kongregatës së Bijve të Zojës së Papërlyer (promotore e Fondacionit ZKM) kaluan në Tiranë nga data 10 deri më 17 dhjetor për një fazë të fundit përgatitore për dedikimin e vetvetes ndaj Zotit. Të rinjtë në fakt, kanë zgjedhur një formë të veçantë të jetës vëllazërore në komunitet, që është e pranishme edhe në Tokën e Shqiponjave që prej vitit 1993.



Java u karakterizua nga takimi me besimtarët tanë "Montianë" të cilët i përkushtohen jetës së Fondacionit në iniciativat e tij nga më të ndryshmet. Nuk munguan takimet me studentët, operatorët dhe shokët e Atë Montit, të cilët përgatitën një moment të bukur argëtues në fund të vizitës. Këta Vëllezër, të ardhur nga vende evropiane mundën të zbulonin historinë e para disa viteve të Shqipërisë, të shënuar nga gati pesëdhjetë vjet diktaturë komuniste dhe izolim ndërkombëtar. Ndikim të veçantë pati vizita në burgjet e Shkodrës ku mbylleshin dhe torturoheshin disidentët si dhe ajo në Bunkerin e madh rrëzë malit të Dajtit, i ndërtuar për të shpëtuar nomenklaturën shqiptare gjatë sulmeve të mundshme bërthamore.

Vizita u karakterizua nga momente reflektimi karizmatik, lutjeje në Shenjtëroren e Shkodrës, relaksi në Tiranën para Krishtlindjeve dhe ekskursionet në disa vende turistike. Në fund u nisën për në Romë, të lumtur për një përvojë të dobishme, të cilës i dhanë notën kolegjiale: 30, shkëlqyeshëm!

DUET ZEMRASH

Poezi dashurie për Shën Valentin



nga
Mimoza Agastra

Dua të humbas kaltërsive të syve të tu,
Aty ku qielli magjishëm ravijëzuar të ka: Konstelacion!
Sa yje dëshirash kam rrëzuar vallë?!
Hojza dashurie, çelur pjalm e dritë.

Urnë zjarri ndez mungesa jote;
Reve të bardha të gjumit tënd,
I lutem t'më sjellë në ëndrrat e tua;
A thua më pret mbi një kalë me flatra?

Flatra i vura mallit, si Pegas i bardhë,
Lumturinë time, si vesë mëngjesi,
Era do të ta sjellë, mëndafsh freskie,
Të të stolisë me ngjyrat e pranverës.

Mos vallë në ëndërr jam, frikë kam ta besoj?
E ëndërrt le të jetë, veç lermë ta përjetoj,
Mund të jetë vegim, por ti mos më zgjo!
Uratë që më ndjek në udhëkryqë dyshimi,
Ajër që frymon, fole plot shpresë jete.

Prej qiellit bie shi rubairash,
Është sprova e rëndë e një dashurie të madhe,
Ruaje në zemër zjarrin e rinisë,
Jetoje të lartën bukuri të pasionit!
Eja perëndesha e dashurisë sime!
Të jetojmë të bukurën magji,
Ëndërr qoftë, a zgjim,
Si mjelmë e bardhë mbi detin e zyrtë.

I dielltë erdhe në shpirtin tim;
S'e di në je lutje a bekim?
Harpë tek kumbon kaltërsive,
Të syve të tu, ëndje e harrim.

Sirenë e dalë prej detit, pritja mbaroi,
Orezanë mali, më jep krahë lirie
Ta ndalim kohën në zenit dashurie.

Erdh pranvera, pranvera pa mbarim,
Mbuluar petalesh vello nusërie,
Ojna, arabeska, jare dashurie,
Të dy bashkë do jemi në jetë e amshim!

Takimet e ardhshme



27-28 Shkurt 2025

Panairi Work & Study në Tiranë

Në Tiranë në Pallatin e Kongreseve do të mbahet në **27 dhe 28 Shkurt 2025 Panairi i përvitshëm Work & Study, Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë"** do të ketë si çdo vit stendën e tij dhe stafin e përgatitur për të dhënë të gjitha përgjigjet e pyetjeve të gjimnazistëve.

Të rinjtë do të informohen për programet tona të pakonkurueshme të studimit në Arkitekturë, Ekonomi, Infermieristikë, Fizioterapi, Odontoiatri e Proteza Dentare dhe Mjekësi.

I mirëpresim gjimnazistët e Tiranës për t'u njohur me mundësitë e jashtëzakonshme që fitojnë kur zgjedhin UKZKM, ndaj shënojin data 27 dhe 28 shkurt.

X CONGRESSO DILLE

LINGUE, TERRITORI E CONTESTI:
LE POLITICHE LINGUISTICO-EDUCATIVE OGGI

22-24 MAGGIO 2025

Università Cattolica
"Nostra Signora del Buon Consiglio"
Tirana, Albania



La Società DILLE (Società Italiana di Didattica delle lingue e Linguistica educativa) in collaborazione con il Centro Linguistico di Ateneo dell'Università Cattolica "Nostra Signora del Buon Consiglio" e la Scuola Italiana a Tirana organizzano il X Congresso dal titolo:

"Lingue, territori e contesti: le politiche linguistico-educative oggi", che si terrà a Tirana dal 22 al 24 maggio 2025.

Si invitano studiosi, ricercatori e professionisti dell'ambito linguistico a presentare i propri contributi entro il **20 gennaio 2025**, seguendo tutte le informazioni sul sito DILLE <https://www.societadille.it/>
Per ulteriori informazioni scrivere a: n.hoti@unizkm.al



KONKURS SPECIALIZIMI

në:

- Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi Intensive
- Kirurgji të Përgjithshme
- Gastroenterologji
- Gjinekologji dhe Obstetrikë
- Sëmundjet e Aparatit Kardiovaskular
- Nefrologji
- Ortopedi dhe Traumatologji
- Shkencat e të Ushqyerit
- Kirurgji Plastike, Rikonstruktive dhe Estetike
- Kirurgji Maksilofaciale
- Urologji
- Otorinolaringologji

Apliko deri më:
13 SHKURT 2025

#PROGRAMSPECIALIZIMI



Botim i ri

Mund ta gjeni tek Biblioteka ZKM

